

VENDIM
Nr. 81/2014

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË NJË GRUPI DEPUTETËSH “PËR NGRITJEN E
NJË KOMISIONI HETIMOR PËR TË KONTROLLUAR ZBATIMIN E
LEGJSLACIONIT NË FUQI PËR ADMINISTRIMIN E BAZAVE TË TË DHËNAVE
SHTETËRORE TATIMORE, SI DHE PËR TË NJOHUR DHE VERIFIKUAR NË
THELLËSI FENOMENIN E NDËRHYRJES DHE BLOKIMIT PËR DISA DITË TË
SISTEMEVE ELEKTRONIKE TATIMORE”**

Në mbështetje të nenit 77 të Kushtetutës, neneve 8 dhe 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, si dhe në zbatim të vendimit nr. 30, datë 16.5.2014, të Gjykatës Kushtetuese,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet komisioni hetimor parlamentar për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh të Partisë Demokratike “Për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi për administrimin e bazave të të dhënave shtetërore tatimore, si dhe për të njohur dhe verifikuar në thellësi fenomenin e ndërhyrjes dhe bllokimit për disa ditë të sistemeve elektronike tatimore”.

II. Komisioni ka si qëllim të veprimtarisë së tij: Mbledhjen e informacioneve të hollësishme mbi zbatimin e legjislacionit në fuqi nga ana e administratës tatimore dhe arsyeve të mosfunksionimit të sistemeve të tatimeve për disa ditë, duke evidentuar problematikat përkatëse dhe për të gjetur zgjidhjet për të ardhmen, nëpërmjet dhënies së rekomandimeve, nxjerrjen e përgjegjësisë institucionale, nevojën e ndryshimeve apo miratimeve ligjore dhe, sipas rastit, njoftimin e prokurorisë për marrjen e masave të mëtejshme ligjore.

III. Objekt i veprimtarisë së komisionit është “Për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi për administrimin e bazave të të dhënave shtetërore tatimore, si dhe për të njohur dhe verifikuar në thellësi fenomenin e ndërhyrjes dhe të bllokimit për disa ditë të sistemeve elektronike tatimore”.

IV. Komisioni hetimor përbëhet nga 11 anëtarë, 6 anëtarë nga shumica parlamentare dhe 5 anëtarë nga opozita. Kryetari i komisionit i takon grupit të deputetëve nismëtarë dhe zëvendëskryetari i takon shumicës parlamentare. Emrat e anëtarëve të tij përcaktohen me vendim të Kuvendit.

V. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij në një afat prej 2 (dy) muajsh nga data e miratimit të tij.

VI. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm për krijimin e kushteve të punës dhe mbështetjen logjistike të veprimtarisë së këtij komisioni hetimor.

VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 23.10.2014